VENDIM
Nr.643, datë 27.9.2006

PËR NORMAT E TRAJTIMIT ME USHQIM TË PUNONJËSVE NË SHËRBIMIN INFORMATIV TË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 34 të ligjit nr.9357, datë 17.3.2005 "Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit", me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit gëzojnë të drejtën e trajtimit me ushqim, në kuotën 125 lekë në ditë, e cila është kundërvlera në lekë e trajtimit me drekë e punonjësit të SHISH-it, sipas normës 4 të ushqimit.
2. Kuota ditore, e përcaktuar në këtë vendim, ndryshon me ndryshimin e indeksit të çmimeve të artikujve ushqimorë të normës 4, me miratimin e Ministrisë së Financave.
3. Trajtimi i çdo punonjësi sipas këtij vendimi të bëhet vetëm për ditët efektive të punës. Këtë trajtim nuk e përfitojnë punonjësit, që, për arsye shërbimi, paguhen me dietë, që janë me leje të zakonshme, raport paaftësie etj.
4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Shërbimin Informativ të Shtetit.
5. Vendimi nr.28, datë 28.1.2000 i Këshillit të Ministrave "Për trajtimin e ushtarakëve të shërbimit aktiv të përhershëm, që shërbejnë në strukturat e Shërbimit Informativ të Shtetit", shfuqizohet.
6. Ngarkohet Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha